

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje prej gjyqtarës Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionist, Vesel Ismaili dhe Isuf Makolli, me procesmbajtëse Lindita Sylejmani, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarve: S.G., për shkak të veprës penale, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, nga neni 346 të KPK-së, dhe M.V., për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i besimit, nga neni 269 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Komunale në Prizren, tani Prokurorisë Themelore në Prishtinë–Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.1338/09 të dt. 23.10.2012, pas përfundimit tëshqyrtimit gjyqësor, të hapur, verbal, me datë 21.03.2018,në praninë e Prokurorit të shtetit, Merrushe Llugini, të akuzuarve S.G., me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.I.M. dhe Xh.K., M.V.,me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.F.L., të dëmtuarit Rr.B., me përfaqësuesin e tij av. R.Z., në bazë të nenit 366 të KPPRK-së, pas tri ditësh me dt.**26.03.2018**,mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I.

I akuzuari: S.G., nga i ati Rr. dhe nëna H., e vajzërisë A., i lindur më ..., në P., ku edhe tani jeton në Lagjen “T.”, rruga “L.G.” pn., me numër personal ..., ka të kryer Fakultetin Juridik, me profesion ish gjyqtar, tani në pension, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepe: Me datë 24.03.2009, si gjyqtar ekzekutues pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, të dobisë pasurore për personin tjetër – këtu të akuzuarit M.V. dhe shkaktimin e dëmit për personin tjetër Rr.B., në cilësi të gjyqtarit merr vendim të kundërligjshëm gjyqësor dhe atëAktvendim E.nr.363/03, të datës 24.03.2009, me të cilin aprovon propozimin e avokatit M.V. dhe I.Sh., si të autorizuar të debitorit B.S., sipas autorizimit Vr.nr.241/09, të datës 22.01.2009, të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë – Dega Graçanicë dhe abrogon masën e përkohshme të caktuar me Aktvendimin E.nr.363/03, të datës 02.06.2003, në bazë të propozimit të kreditorit Rr.B., duke u bazuar në kërkesën gojore të avokatit M.V., të konstatuar nëprocesverbalin e datës 24.03.2009, pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, me arsyetimin se kreditori sipas lëndës E.nr.363/03, Rr.B. – këtu i dëmtuari ka vdekur si dhe pasi gjykata konstatoj, se lënda C.nr.911/03, kinse ka përfunduar, meqenëse paditësi gjegjësisht kreditori Rr.B. ka vdekur, andaj dhe procedura është ndërprerë, me ç ‘rast këtu i akuzuari pa vërtetuar me asnjë provë relevante këtë fakt, me aktvendimin E.nr.363/03, të datës 24.03.2009, shfuqizon aktvendimin mbi caktimin e masës së përkohshme E.nr.363/03 të datës 02.06.2003, duke marr si të tillë një vendim të kundërligjshëm gjyqësor.

- me këtë ka kryer veprën penale, Nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësorenga neni 346 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49,50, 51,52 dhe 73, të KPRK-së dhe neneve 359, 365 dhe 366 të KPP-së të akuzuarit i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit S.G., i cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë Euro (50 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.

I akuzuari: M.V., nga i ati H. dhe nëna Sh.1, e vajzërisë A., i lindur më ..., në Sh.2 Komuna e P.1, tani me vendbanim në P.2, rruga “Xh.M.” nr. ..., me numër personal ..., ka të kryer Fakultetin Juridik, me profesion avokat, tani në pension, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3 të KPP të Republikës së Kosovës;

LIROHET NGA AKUZA

Sepse: Me datë 24.03.2009, si i autorizuar, në cilësi të avokatit të B.S., në bazë të autorizimit Vr.nr.241/09, të datës 22.01.2009, të vërtetuar pranë Gjykatës Komonale në Prishtinë – Dega Graçanicë, keqpërdorë autorizimin e tij, me qëllim që vetës t’i sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që duke pasur interes nga shfuqizimi i masës së përkohshme E.nr.363/09 të datës 26.02.2003, pasi pretendonte që sipërfaqen prej 5.75 ari, të ngastrës kadastrale nr.287/4, sipas listës poseduese 991 ZK Graçanicë, në vendin e quajtur “V.”, e kishte blerë nga Sh.G. dhe ky i fundit nga B.S., për të cilën ngastër ishte caktuar masa e përkohshme, shkon në zyrën e gjyqtarit – këtu të pandehurit të parë S.G. dhe deklaronte se Rr.B. (kreditor sipas lëndës E.nr.363/03) ka vdekur, dhe me këtë veprim keqpërdorë besimin me qëllim të shfuqizimit të masës së përkohshme E.nr.363/03 të datës 02.06.2003, dhe përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete.

- sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 269 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Shpenzimet gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore, të kësaj gjykate.

I dëmtuari, Rr.B., me vendbanim në rr.“Xh.A.” nr. ..., në P.2, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Komonale në P.1, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP.nr.1338/09 të dt. 23.10.2012, kundër të akuzuarve S.G., për shkak të veprës penale, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, nga neni 346 të KPK-së, dhe M.V., për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i besimit, nga neni 269 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale ku menjëherë pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarve i është dhënë mundësia e deklarimit të tyre lidhur me fajësinë, të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, u deklaruan të pafajshëm, andaj gjykata vazhdoi me seancën e shqyrtimit gjyqësor, me radhën e paraqitjes së provave, me fjalën hyrëse, dëgjimin e të dëmtuarit, leximin e deklaratës së dëshmitares, administrimin e provave materiale, me mbrojtjen e të akuzuarve dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare dorëzuar kësaj gjykate me shkrim ndër të tjera ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e analizimit të të gjitha provave relevante si të natyrës materiale ashtu edhe personale të administruara është vërtetuar në tërësi se të akuzuarit S.G. dhe M.V., duke vepruar me elementin subjektiv kryesor të fajësisë – dashjen kanë kryer veprat penale sikurse në rrethanat të cilat janë përshkruar si në dispozitiv të pikës I dhe II të aktakuzës. Ka theksuar se nga provat e administruara janë vërtetuar faktet me rëndësi së i akuzuari S.G. si gjyqtar i çështjes në procedurën përmbartimore sipas lëndës E.nr.363/03, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe ka marrë një aktvendim të kundërligjshëm të datës 24.03.2009, me një shpejtësi e ka aprovuar propozimin e të akuzuarit M.V. në atë kohë si avokat i debitorit B.S. duke u bazuar vetëm në kërkesën gojore të tij dhe duke mos e provuar me prova relevante. Ka shtuar se gjyqtari i çështjes S.G., tani si i akuzuar nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të siguruar certifikatën e vdekjes për Rr.B., dhe po ashtu nuk e ka njoftuar avokatin e kreditorit – të dëmtuarit Rr.B. për aktvendimin e marrë të datës 24.03.2009, dhe as për kërkesën e parashtruar nga avokati M.V. tani i akuzuar. Në fund ka theksuar se në veprimet e të akuzuarve në tërësi janë manifestuar elementet esenciale me figurën konkrete të veprave penale për të cilat akuzohen dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shpallë fajtor për veprat penale të kryera dhe t'i dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. R.Z. në fjalën e tij përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurores së shtetit e cila në mënyrë të qartë dhe të saktë e ka përshkruar kryerjen e veprave penale nga të akuzuarit si dhe dëmtimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit Rr.B.. Ka theksuar se provat e administruara në seancën e mëparshme gjyqësore e kanë vërtetuar faktin e pamohueshëm se veprat penale nga të akuzuarit janë kryer me dashje e të cilin fakt e vërteton edhe deklarata e dëshmitares – ish gj. S.M. e cila në mënyrë kategorike e ka kundërshtuar kërkesën e të akuzuarve për abrogimin e masës së përkohshme të sigurimit edhe me faktin të cilin ua ka shpjeguar se meqë ajo është gjyqtare e çështjes ajo është e autorizuar që të nxjerrë ose të abrogojë masën e sigurimit në këtë çështje kontestuese. Ka shtuar se me veprimin e të akuzuarve të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material dhe dëm jo material, dhe se me heqjen e kësaj mase ose abrogimin e kësaj mase i akuzuari M.V. e ka shfrytëzuar rastin dhe me keqpërdorim me të paditurin B.S. me kontrata interne apo gojore e ka blerë një pjesë ose disa ngastra të paluajtshmërisë kontestuese, dhe qëllimi kryesor i tij ka qenë me abrogimin e masës të futet në paluajtshmërinë kontestuese të dëmtuarit Rr.B.. Prandaj i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara të merr vendim në bazë të ligjit ndërsa palën e dëmtuar të udhëzoj në kontest civil për realizimin e të drejtës së tij për dëmin e shkaktuar.

I dëmtuari – dëshmitari Rr.B. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit e po ashtu edhe të përfaqësuesit av. R.Z.. Mirëpo ka shtuar se e konsideron vetën se është i dëmtuar për çka edhe në seancën e fundit parashtrorj kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.G., av. I.M. në fjalën e tij përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim, duke theksuar se në fjalë përfundimtare të prokurores dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar janë përfshirë prova të papranueshme përkatësisht ato që nuk janë as propozuar për administrim. Po ashtu ka theksuar se prokurorja në fjalën përfundimtare e ka përfshirë dashjen duke u referuar në aktakuzë, e që nuk qëndron dhe se nga vet elaborimi i cili në fakt ishte leximi i aktakuzës deklaroi se i akuzuari i dytë me B.S. ka lidh kontratë në 2008, pra para marrjes së aktvendimit me të cilin po pretendon së është kryer vepra penale. Ka theksuar se prokurorja nuk ka mundur të specifikojë përfitimin për personin tjetër e as dëmin e shkaktuar me vendim të kundërligjshëm, sepse është vërtetuar se të njëjtat nuk kanë ekzistuar dhe se nën supozimin e ekzistimit të këtyre elementeve, prokurorja ka qenë dashur të siguroj prova për qëllimin (dashjen direkte) në aspektin specifik, për dëmin dhe përfitimin pasuror, e paraprakisht që të konstatohet paligjshmëria e vendimit gjyqësor. z. S.G. jo që nuk e ka bërë veprën e pretenduar penale, por i njëjti ka vepruar në tërësi në pajtim me ligjin, e sipas kompetencave të tij, në cilësinë e gjyqtarit. Ka theksuar se për të ekzistuar dashja, duhet që kjo dashje të ekzistoj me dëmin specifik dhe të jetë i parashikuar nga gjyqtari, me rastin e marrjes së vendimit të kundërligjshëm. Po që se do të kishte dashje që të dëmtohetkushdo qoftë apo të përfitoj i

akuzuari i dytë M.V., z. S.G. nuk do të caktonte afatin e ankesës me karakter suspenziv, i njëjti nuk do t'ia dorëzonte përfaqësuesit të palës së dëmtuar aktvendimin dhe i njëjti do të ekzekutonte aktvendimin në fjalë duke lejuar shitblerjen e paluajtshmërisë për të cilën është lëshuar masa e përkohshme. Nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që aktakuzën ta hedhë dhe procedura penale të pushoi, apo të liroj z. S.G. nga aktakuza, për shkak se veprimet e tij nuk përmbajnë elementet e veprës penale të përfshirë në aktakuzë.

I akuzuari S.G., në seancën e shqyrtimit gjyqësor shfrytëzoi të drejtën e tij ligjore që të mbrohet në heshtje duke theksuar se qëndron në tërësi pranë deklaratimeve-mbrojtjes që i ka dhënë në fazën e mëhershme. Në deklaratën e dhënë në polici me datë 17.04.2009 dhe deklaratën e dhënë në prokurori me datë 17.05.2015, i akuzuari S.G. ndër të tjera ka deklaruar se "...ishte tek unë në zyre disa herë avokati M.V., duke u interesuar për një lëndë që e kishte në gjykatë në punim dhe me qenë se ishte aq i mërzitshëm në lidhje me këtë lëndë e ku kërkonte që të abrogohet masa e përkohshme, ai bashkë me të kanë shkuar të gjyqtarja e gjykatës komunale në Prishtinë, S.M. e cila ishte duke zhvilluar procedurën kontestimore me palët të cilat kanë qenë edhe tek ai në lëndën e tij për abrogimin e masës së përkohshme...se e ka pyetur gjyqtaren S.1 "a e ke këtë lëndë" dhe ajo i ishte përgjigjur me "po" të njëjtës i ka treguar se ky avokat po kërkon me tërheq masën e përkohshme.S.M.iu ka drejtuar avokatit duke i thënë "a e ke sjell certifikatën e vdekjes" duke menduar në Rr.B., avokati i ka thënë "gjyqtare nesër kam me ta sjellë certifikatën", dhe pas kësajS.M.ia ka bërë me gisht duke i thënë me zë të ulët për t'ia hequr atë masë. Atëherë ai e ka marrë lëndën dhe ka dalë nga zyra e saj e ka shkuar në zyrën e tij, aty e ka pyetur avokatin se kur do ta sillte atë certifikatë të vdekjes dhe ai i ka thënë se do ta sillte të nesërmen...pasi që ka verifikuar autorizimin e ka përpiluar një procesverbalnë të cilin ka cekur kërkesën e avokatit dhe ka sqaruar se ka bërë bisedë me gjyqtaren SanijeMuqolli, dhe pas nënshkrimit të këtij procesverbali nga ana e avokatit i ka thënë daktilografës se tij që ta shtyp aktvendimin me numër E.nr.363/03 të datës 24.03.2009 me të cilin e ka abroguar aktvendimin e mëparshëm...dhe pasi kanë kaluar disa ditë një person ka hyrë në zyrën tij duke thënë "kush është S.G." ai i ka thënë "unë jam" i njëjti i ka thënë "me ke shpall të vdekur"...pasi e ka vërtetuar se i njëjti nuk është i vdekur por i gjallë, me datë 01.04.2009 e ka revokuar aktvendimin që e ka lëshuar me datën 24.03.2009, kështu që gjendja është kthyer në gjendjen e mëparshme, masa e përkohshme ka mbetur në fuqi...ishte i sigurt që askujt nuk i është shkaktuar dëm dhe se nuk ka pasur kurrfarë qëllimi të përfitimit por kjo thjeshtë ka qenë një besim në avokatin në fjalë, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka me tepër çka të deklaroj.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.V., av. FlorentLatifaj në fjalën e tij përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se i akuzuari M.V. akuzohet për veprën penale të keqpërdorimit të besimit se kinse e ka keqpërdor autorizimin e dhënë nga B.S.. Ka theksuar se për të ekzistuar kjo vepër penale M.V. është dashur që të ndërmarr veprime të cilat do t'i shkonin në dëm B.S. e jo në favor të tij, në rastin konkret M.V. ka kërkuar shfuqizimin e një mase e cila është caktuar kundër autorizuesit të tij B.S.i, pra paska tentuar që të bëjë diçka në favor të B.S.i, ndërsa aktakuza e akuzon se ka keqpërdorur autorizimin me qëllim që vetit t'i sjell përfitime pasurore, pra cili element është përmbushur për ekzistimin e veprës penale, edhe sikur të ishte shfuqizuar masa, ç'farë dëmi do t'i ishte shkaktuar B.S., vetëm favor ishte shkaktuar sepse ai do të përfitonte. Nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së ta liroj të njëjti nga aktakuza ngase edhe me pas dashur të kryej këtë vepër penale nuk e ka pasur atë cilësi në rastin konkret.

I akuzuari M.V., në seancën e shqyrtimit gjyqësor shfrytëzoi të drejtën e tij ligjore që të mbrohet në heshtje duke theksuar se mbetet pranë mbrojtjes që e ka dhënë në fazën e hetuesisë. Në deklaratën e dhënë në polici me datë 22.04.2009, i akuzuari M.V. ndër të tjera ka theksuar se "...ditën kritike ka pasur vetëm autorizim përcjellës vetëm për atë ditë nga pronari i tokës B.S. nga P.2 që të zëvendësoj avokatin Zh.J., meqenëse i njëjti ka qenë në B....për këtë çështje ia kanë thënë mbi 50 herë E.G., I.Sh., M.Sh. dhe R.Sh. se kinse njëfarë Rr. ka vdekur para disa viteve..., te S.G. ka shkuar me tepër se 20 herë dhe i ka thënë se kanë pushuar të gjitha kushtet për ndërprerjen e masës së përkohshme...se bashku me S.G. ka

qenë të gjyqtarja e rastit S.1 dhe e njëjta në prezencën e tij i ka thënë S.2 hiqe masën e përkohshme se lëndën e kam caktuar me tepër se dhjetë herë dhe askush nuk ka ardhur nga avokatet..., ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga akuza, jam i pafajshëm dhe personin në fjalë për herë të parë e kam takuar në gjykatë, asnjëherë nuk ka marrë pjesë në seancat që janë mbajtur në procedurë civile për çka gjykatës i dëshmoj me aktgjykimin e shkallës së parë.

I dëmtuari – dëshmitari Rr.B. në dëshminë e tij gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë, deklaroi sederisa ishte të fëmijët si mysafir në Gj., e ka njoftuar përmes telefonit djali i vëllait se diçka po zihet me lëndën që e ka në gjykatë prej vitit 2003, se diçka po zihet përmes avokatëve se gjeja ai është i sëmur apo i vdekur, se pas kësaj e ka njoftuar avokatin e tij S.G. dhe ai i ka thënë se M.V. të ka shpallur të vdekur...se kur e ka marr vendimin prej avokatit të tij ka shkuar se pari të gjyqtari S.G. dhe kur ka hy të S.2...i ka thënë se shihe kush je t'i, çka me ke lëshua mua, dhe ka fillu me kërku falje, dhe se kjo ka qenë pas 4-5 ditësh pasi është lëshuar vendimi, dhe se S.G. i ka thënë se a ke biseduar me S.3 që është bërë gabim teknik. Deklaroi se S.G. e ka afër me shtëpi, me afër se 1 km vijë ajrore dhe se është njohur me S.2. Tokën që ishte në kontest në gjykatë që nga viti 2003, ai se bashku me babain e tij në vitin 1970 e kanë blerë prej S.U.-baba i B.S. në sipërfaqe prej ... ari e cila me vonë ka dalë se është ... ari, e cila gjendet në hyrje të Q., në kohën kur e kanë blerë tokën nuk kanë lidhur kontratë sepse problemi ka qenë se S.U. nuk e kishte paguar tatimin për shumë vite, ndërsa në lidhje me M.V. theksoi se ishte kundërshtar i tij në gjykatë sepse ka pretenduar me i ndihmua B.S., ishte avokat i tij dhe e tërë punë ka qenë rreth kësaj prone, ngase M.V. i ka tri troje në tokën e tij në Q., dy i ka shitur M.Sh. dhe një e ka ndalur për vete. E ndjen vetën të dëmtuar sepse nuk mundet të del me askënd në qytet duke i thënë njeri i vdekur, është dëmtuar edhe me të holla, ngase vlera aty arrin deri 38 mijë Euro shkon ari i tokës, është dëmtuar materialisht dhe moralisht.

Dëshmitarja S.M. nuk është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor pasi që gjykata ka aprovuar propozimin e palëve që deklarata e saj e dhënë në polici me dt.16.04.2019, të lexohet. Në deklaratën e dhënë në polici dëshmitarja S.M. ndër të tjera ka theksuar se "...ajo është e ngarkuar me lëndën me numër C.nr.911/2003, ku paditës është Rr.B. kurse i paditur është B.S....avokati i të paditurit B.S., M.V. ka kërkuar që ta abrogoj masën e sigurisë së përkohshme me të cilën ndalohet shitblerja e palujtshmërisë, dhe se ajo nuk e kapranuar ta abrogoj pasi që e ka pa të arsyeshme se e njëjta duhet të mbetet në fuqi, dhe i njëjti ka propozuar që procedura në këtë çështje të ndërpritet pasi që paditësi Rr.B. ka vdekur, dhe procedurën nuk ka ndërprerë derisa të silltet certifikata nga libri amëz i të vdekurve. Nuk i kujtohet dita e saktë, ka qenë jashtë zyrës për konsultim dhe kur është kthyer në zyre e ka gjetur gjyqtarin S.G. i cili ka qenë i ulur në karrige, kurse avokati M.V. ka qëndruar në këmbë. Gjyqtari S.G. e ka pyetur "a do ta abrogosh masën e përkohshme pasi procedurën e ke ndërpre për shkak të vdekjes së Rr.B.", gjyqtarin e ka njoftuar se masën e përkohshme nuk do ta abrogoj pasi që nuk janë plotësuar kushtet, gjithashtu procedurën e njëjta nuk e ka ndërpre për shkak të vdekjes kinse të Rr.B. t'gjersa nuk i është prezantuar në shkresat e lëndës certifikata nga libri amëz i të vdekurve, e pas përfundimit të kësaj bisede gjyqtari S.G. i ka thënë avokatit M.V. "hajde të shkojmë lartë në zyre" kanë dalë nga zyra saj së bashku dhe ajo nuk ka njohuri me tutje se çka është ndërmarrë. Nuk është e vërtetë që i ka thënë S.G. që ta abrogoj masën e përkohshme nga arsyeja se po të ishin plotësuar kushtet për masën e përkohshme do ta kishte abroguar vetë atë masë e nuk do ti thoshte gjyqtarit tjetër (S.G.)...".

Gjykata ka administruar provat materiale të propozuara në aktakuzë siç janë: Aktvendimi E.nr.363/03, dt. 02.06.2003, Procesverbali E.nr.363/03, dt. 24.03.2009, Aktvendimi E.nr.363/03, dt. 24.03.2009, Aktvendimi E.nr.363/03, dt. 01.04.2009, Autorizimi VR.nr.241/09, dt. 22.01.2009, i vërtetuar pranë gjykatës Komonale në Prishtinë, Dega në Graçanicë, Deklarata VR.nr.6996/2008, e vërtetuar pranë gjykatës Komonale në Prishtinë, Dega në Graçanicë, aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.911/03, dt. 28.01.2010.

Rrjedhimisht trupi gjykues, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave materiale, dëgjimit të dëmtuarit dhe dëshmitares, mbrojtjes së të akuzuarve dhe pas vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një

dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, konform nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, vërtetoi gjendjen faktike në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Është fakt i pakontestueshëm se gjyqtari i çështjes Ferid Bislimi duke vendosur sipas propozimit të kreditorit Rr.B. kundër debitorit B.S. ka caktuar masën e përkohshme ndalimi i tjetërsimit – legalizimit të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë – arë e klasitë katërt në vendin e quajtur V.G.G., në sipërfaqe prej ... ha, ngastra kadastrale nr. ... të evidentuar në fletën poseduese nr.... përkatësisht 991, plani nr. 7 KK Q., Komuna P.3. Ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarëve dhe nga prova materiale Aktvendimin E.nr.363/2003, dt. 02.06.2003.

Është fakt i pakontestueshëm se i akuzuari S.G., nëcilësinë e gjyqtarit në çështjen përmbartimore të kreditorit Rr.B. kundër debitorit B.S. të cilin e përfaqëson av. M.V. dhe I.Sh., duke vepruar sipas kërkesës gojore të av. M.V. për shfuqizimin e masës së përkohshme (E.nr.363/03, të dt. 02.06.2003) ka marr aktvendim E.nr.363/03, dt. 24.03.2009, me të cilin ka aprovuar propozimin e av. M.V. dhe I.Sh., dhe ka abroguar aktvendimin për masën e përkohshme me arsyetimin se kanë pushuar të gjitha elementet për të njëjtën meqenëse kreditori Rr.B. ka vdekur.Ky fakt vërtetohet edhe nga provat materiale aktvendimin E.nr.363/03, dt. 24.03.2009, dhe Procesverbali E.nr.363/03, dt. 24.03.2009.

Nuk është kontestuese fakti se i akuzuari S.G., pasi që në zyrën e tij është paraqitur i dëmtuari Rr.B., sipas detyrës zyrtare ka marr aktvendim për revokimin e aktvendimit mbi abrogimin e masës së përkohshme E.nr.363/03 dt. 01.04.2009. Ky fakt vërtetohet edhe nga prova materiale aktvendimin E.nr.363/03, dt. 01.04.2009.

Nuk është kontestuese fakti se i akuzuar M.V.dhe av. I.Sh. kanë qenë të autorizuar nga B.S. që të përfaqësojnë atë pranë Gjykatës Komonale në Prishtinëdhe që t'i ushtrojnë mjetet juridike që shkojnë në interes të tij për heqjen e masës së përkohshme E.nr.363/2003, të dt. 02.06.2003 në ngastrën kadastrale nr. ... të evidentuar në fletën poseduese nr. ... përkatësisht ..., plani nr. ... KK Q., Komuna P. Ky fakt vërtetohet edhe nga prova materiale Autorizimi VR.nr.241/09, dt. 22.01.2009, i vërtetuar pranë gjykatës Komonale në Prishtinë, Dega në Graçanicë.

Po ashtu nuk është kontestuese se i akuzuari i M.V.ka pasur interes personal për abrogimin e masës së përkohshme për arsye se në paluajtshmërinë (ngastrën kadastrale 287 të evidentuar në fletën poseduese nr. ... ZK Q.) në të cilën ka qenë e vendosur masa e përkohshme i njëjti ka pasur pretendime pronësore në sipërfaqen ... ari. Ky fakt u vërtetua edhe nga deklaratat e të dëmtuarit dhe nga prova materiale Deklarata VR.nr.6996/2008, e vërtetuar pranë gjykatës Komonale në Prishtinë. Për me tepër, këtëfakt e ka pohuar edhe vet i akuzuari M.V. në deklaratën e dhënë në polici me dt. 22.04.2009.

Kontestuese ishte fakti nëse i akuzuari S.G. ka vepruar brenda kompetencave të tij ligjore apo ka vepruar nëmënyrë të kundërligjshme kur ka vendosur për abrogimin e masës së sigurisësipas propozimit gojor të akuzuarit M.V., me arsyetimin se ka vdekur i dëmtuari Rr.B. edhe pse për këtë fakt nuk kishte asnjë provëmateriale – certifikatë të vdekjes.

Po ashtu kontestuese ishte fakti nëse i akuzuar M.V.me deklarimin e dhënë në procesverbal se kreditori – i dëmtuari Rr.B. ka vdekur dhe me propozimin që masa e përkohshme të abrogohet,ka keqpërdorur autorizimin e dhënë nga B.S., dheka keqpërdorur besimin e tij, me qëllim që vetit t'i sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme.

Nga deponimi i dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit Rr.B., gjykata vërtetoi faktin se në kohen kur është marr aktvendimi për abrogimin e masës së përkohshme, nga ana e të akuzuarit S.G., i dëmtuari ishte në Gj. në vizitë familjare të fëmijët e tij dhe se nga avokati i tij S.G. përmes telefonit ka kuptuar se të akuzuarit M.V. dhe S.G. e kanë shpallur të vdekur. Po ashtu nga deklarimi i të dëmtuarit u vërtetuar fakti se i akuzuari S.G. ka pranuar se ka bërë gabim kur ka vendosur që ta abrogoj masën e përkohshme,

mirëpo këtë gabim i akuzuari S.G. është munduar që të arsyetoj se nuk është bërë me qëllim dhe se gjëja është bërë një gabim teknik.

Sa i përket deklaratës së të dëmtuarit se ai me të akuzuarin S.G. janë njohur me parë për shkak se shtëpitë i kanë afër njëri tjetrit vijë ajrore ... km në P.2, dhe se si kontrollor i autobusëve në K. T. e ka gjetur disa herë S.G. pa biletë, gjykata nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor këtë fakt nuk mundi ta vërtetoj. Fakti se ata i kanë shtëpitë afër njëri tjetrit në një distancë 1 km vijë ajrore nuk do të thotë se ata automatikisht njihen mes veti, e sidomos kur bëhet fjalë për vendbanimin në Qytet - P.2. Po ashtu edhe nëse merret si i vërtet fakti se i akuzuari S.G. ka udhëtuar me autobusin K.T. ku kontrollor ka qenë i dëmtuari Rr.B., nuk është bazë e mjaftueshme për me vërtetu se ata kanë njohur njëri tjetrin personalisht për shkak se si udhëtar në transportin publik mundësi ta njohësh kontrollorin si figurëpor jo edhe me emër dhe mbiemër.

Nga deponimi i dëshmisë së dëshmitares S.M., gjykata vërtetoi faktin se të akuzuarit S.G. dhe M.V. kishin shkuar në zyre të saj e cila ishte e ngarkuar me lëndën me numër C.nr.911/2003, ku paditës ishte Rr.B. kurse i paditur B.S., që ka pasur të bëjë me padinë e të dëmtuarit Rr.B. për vërtetimin e pronësisë së paluajtshmërisë në të cilën ka qenë e vendosur masa e përkohshme, dhe se i akuzuari S.G. e kishte pyetur "a do ta abrogosh masën e përkohshme pasi procedurën e ke ndërpre për shkak të vdekjes së Rr.B.", mirëpo dëshmitarja e kishte njoftuar të akuzuarin S.G. se masën e përkohshme nuk do ta abrogoj pasi që nuk janë plotësuar kushtet dhe se procedurën nuk e kishtendërpre për shkak të vdekjes kinse të Rr.B. t sepse në shkresat e lëndës nuk gjendet certifikata nga libri amëz i të vdekurve, dhe se pas kësaj i akuzuari S.G. i ka thënë të akuzuarit M.V. hajde të shkojmë lartë në zyre, dhe ka deklaruar se nuk është e vërtetë që i ka thënë S.G. që ta abrogoj masën e përkohshme nga arsyeja se po të ishin plotësuar kushtet masën e përkohshme do ta kishte abroguar ajo vet e jo t'i thotë gjyqtarit tjetër. Nga dëshmia e dëshmitares vërtetohet fakti se i akuzuari M.V. disa herë kishte kërkuar nga dëshmitarja që ta abrogoj masën e përkohshme, mirëpo e njëjta nuk kishte pranuar derisa ta sjellin certifikatën e vdekjes së të dëmtuarit Rr.B. dhe se i akuzuari S.G. ishte në njohurisë nuk janë plotësuar kushtet ligjore për abrogimin e masës së përkohshme dhe për këtë arsye ka kërkuar nga dëshmitarja S.M. që ta abrogoj të njëjtën.

Arsyetimi i të akuzuarit S.G. se ai i ka besuar M.V. kur ka deklaruar se kreditori Rr.B. ka vdekur është i pajustificueshëm. Është e ditur se për vendosjen në lidhje me propozimin për caktimin e masës së përkohshme gjykata duhet të veproj me urgjencë dhe kjo është e rregulluar me dispozitë ligjore, mirëpo nuk ka kurrfarë urgjence heqja e saj. I akuzuari S.G. ka deklaruar së M.V. i ka thënë se të nesërmen do ta sjellë certifikatën e vdekjes, atëherë në qoftë se ka qenë kështu dhe në qoftëse ka besuar se në të vërtetë ka vdekur i dëmtuari Rr.B., pse nuk ka pritur edhe një ditë në mënyrë që të vërtetohet ky fakt. Pra këtu nuk ka pasur kurrfarë urgjence, prandaj ngutshmëria e të akuzuarit S.G. për të vendosur pa prove dhe krejt kjo në kundërshtim me ligjin, e vërtetojnë faktin se ai ka qenë në dijeni se i dëmtuari nuk ka vdekur dhe se nxjerrja e vendimit në mënyrë të kundërligjshme është bërë për t'i sjell favore të akuzuarit M.V.. Gjikata në tërësi ia fali besimin deklaratës së dëshmitares pasi që e njëjta ishte në përputhje edhe me deklarin e të dëmtuarit dhe me provat materiale.

Gjikata po ashtu shqyrtoi edhe fjalën përfundimtare të mbrojtësit të të akuzuarit S.G., vlerësoi se e njëjta kishte për qëllim shfajësimin e të mbrojturit të tij dhe pretendimet se nuk përmbushën elementet e veprës penale për të cilën akuzohet dhe se i akuzuari S.G. ka vepruar në kuadër të kompetencave të tij ligjore, por ishin të shumta provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat e vërtetuan fajësinë e të akuzuarit, andaj gjykata pamëdyshje vërtetoi se i akuzuari S.G. me veprimet e tij ka kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjikata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara konstatoi gjendjen si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, nxjerr konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe gjeti se në veprimet e të akuzuarit S.G. janë konsumuar elementet esenciale të veprës penale të lartcekur, pasi që më parë gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë

penale të tij, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPK-së, ku si rrethana lehtësuese gjeti, se të njëjti më parë nuk qenë të dënuar për ndonjë veprë tjetër penale dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetre penale, gjendjen e tij shëndetësore se i njëjti është i sëmur, se ka kaluar një kohë e gjatë prej momentit kur është kryer vepra, se i akuzuari pas kryerjes së veprës penale i ka eliminuar pasojat e saj duke e abroguar vendimin e kundërligjshëm, se i njëjti ka pasur sjellje të mira gjatëseancës, është kryefamiljar, baba i ... fëmijëve, gjendjen ekonomike, ndërsa rrethana rënduese gjykata mori parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal i shqiptoi dënimin si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit përmes shpalljes së dënimit pa ekzekutimin e dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 50 të KPK-së, që kryerësit t'i jep qortimin, i cili e arrin qëllimin e dënimit përmes shpalljes së dënimit pa ekzekutimin e dënimit, që i akuzuari në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme.

Sa i përket të akuzuarit M.V.trupi gjykues pasi analizoj dhe vlerësoj provat e administruara, deklarin e të dëmtuarit, dëshminë e dëshmitares, nuk gjeti se në veprimet e tij, formësohen elementet e veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 269 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së. Nuk është kontestues fakti se i akuzuari M. kishte kërkuar nga ish gjykatësi abrogimin e masës së përkohshme e që kjo është vërtetuar edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit S.G., i cili e ka pranuar se disa herë i kishte kërkuar një gjë e tillë, po ashtu nuk është kontestuese se i akuzuari M. ju kishte drejtuar me një kërkesë të tillë edhe dëshmitares S.M.e cila po procedonte me lëndën në çështjen civile, e cila në mungesë të provës- Certifikatës së vdekjes kishte kundërshtuar një veprim të tillë e që këtë e vërtetoi vet dëshmitarja në dëshminë e saj se e njëjta nuk kishte pranuar abrogimin e masës pa ofrimin e dëshmisë nga ana e të akuzuarit M.. Po ashtu u vërtetua se në të njëjtën mënyrë vetëm me fjalë-verbale pa mos e dëshmuar me asnjë provë i ishte drejtuar edhe gjykatësit S.2 i cili sipas tij i kishte besuar dhe me vetëm një fjalë të tij se do t'ia sjellë pas një apo disa ditësh dëshminë i kishte mjaftuar për ta abroguar një masë të përkohshme e cila ishte lëshuar prej me shumë se 6 vite. Po ashtu u vërtetua se i akuzuari M.V. dhe I.Sh. kishin një autorizim nga B.S., që të ushtrojnë mjete të rregullat , apo të jashtëzakonshme që shkojnë në interesin e tij për heqjen e masës së përkohshme nr. 363/03 të dt.02.02.2003, në ngastrën katastrale nr.287 të evidentuar në fletën poseduese nr.... përkatësisht ..., plani nr.... K.K.Q.-Komuna e Prishtinës, i cili autorizimi është vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë-Dega në Graçanicë me nr.Ov.br.241/009 të datës 22.01.2009.

Trupi gjykues, pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara konstatoi gjendjen faktike si në dispozitivin e dytë të këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe bazuar në gjendjen faktike të vërtetua gjeti se në veprimet e të akuzuarit M.V.nuk janë përmbushur elementet e figurës së veprës penale, Keqpërdorimi i besimit, kjo për arsye se për të ekzistuar kjo veprë penale, i akuzuari M.V.është dashur që të ndërmerr veprime që shkojnë në dëm të autorizim dhënësit në këtë rast të B.S.. Në rastin konkret i akuzuari M.V. ka kërkuar heqjen e masës së përkohshme e cila ishte kërkesë kryesore e autorizimdhënësit B.S., pra me veprimet tij nuk është dëmtuar B.S., përkundrazi atij i ka konvnuar heqja e masës dhe për këtë qëllim e ka autorizuar. Fakti se i akuzuari

M.V. kishte interes personal për heqjen e masës së përkohshme nuk është relevant për shkak se interesi i tij nuk ishte në kundërshtim me interesin e autorizim dhënësit B.S.. Sipas aktakuzës i dëmtuar është Rr.B. dhe jo B.S. dhe se prokuroria nuk ka arritur që ta provojëse i akuzuari M.V. duke keqpërdorë autorizimin e autorizim dhënësit B., ka dëmtuar apo ka pasur për qëllim ta dëmtoj B.S.. Andaj në mungesë të provave dhe mosekzistimit të elementeve të veprës penale, konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPRK-së, të akuzuarin e liroj nga akuza.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale nga i akuzuari S.G. është marrë në bazë të nenit 450 par.2 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa paushalli gjyqësor është marrë duke pasur parasysh gjendjen materiale të të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, për të akuzuarin M.V. është marrë në bazë të nenit 454 par. 1, të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar.1.3, dhe nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.42/15. dt.26.03.2018

Procesmbajtësja
Lindita Sylejmani

Kryetarja e trupit gjykues
Valbona Musliu-Selimaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.